



Ndal Punës së Fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve
nëpërmjet edukimit,
artit dhe medias

Mjetet e komunikimit,
radioja dhe televizioni

Organizata Ndërkombëtare e Punës

Objektivi: Lidhja me median për të sjellë në vëmendje të saj problemin e punës së fëmijëve. Të kuptosh si punon media. Përgatitja dhe realizimi i një interviste radiofonike ose televizive.



Përfundimi: Rritja e përgjegjshmërisë dhe ndërgjegjësimit të komunitetit nëpërmjet efektit të amplifikimit.

Koha

2 orë mësimi, veçmas ose së bashku.

Motivimi

Puna me radion dhe televizionin është e ndryshme nga puna e shtypit të shkruar. Nëse, siç ju kemi këshilluar, e keni zhvilluar modulën “Mjetet e komunikimit, shtypi”, grupi tashmë do të dijë sa e rëndësishme është përdorimi i medias si mjet komunikimi i shpërndarjes së mesazhit në një publik shumë të gjerë, duke shumëfishuar ndikimin e veprimtarisë që kryhet.

Në të dyja modulet e komunikimit, të rinjtë vlerësojnë si mund t’i përfshijnë mediat në projekt që të mundësojnë informimin e një numri më të madh njerëzish të komunitetit rreth punës së tyre, duke u shpjeguar si ata mund t’i ndihmojnë dhe mund të japin ndihmesën e tyre për këtë problem. Këto module ndërthuren shumë mirë me modulet për shkrimin krijues dhe me intervistën e sondazhet.

Përparësia kryesore e moduleve për mjetet e komunikimit është se të rinjtë mund të zbatojnë në praktikë atë që kanë mësuar. Ky është një hap tjetër përpara për të



rinjtë që i kualifikon në rolin e tyre të agjentit të ndryshimit shoqëror në gjirin e komunitetit.

Në epokën e *ekonomisë së re*, puna me mjetet e komunikimit po bëhet gjithmonë e më shumë e rëndësishme, pasi lajmet dhe informacioni luajnë një rol mbizotërues në jetën e njerëzve. Kjo është me rëndësi për të ardhmen profesionale dhe akademike të të rinjve dhe sigurojnë jetëgjatësinë e asaj që ata kanë mësuar nga këto module.



Shënim për përdoruesin

Para se të realizoni këtë modul, ju këshillojmë të keni zhvilluar modulin “Mjetet e komunikimit, shtypi”, që do ta ndihmojë grupin të krijojë një marrëdhënie më të ngushtë me median, si një sistem i mirë për të filluar të njohësh këtë botë. Kur bëhet fjalë për të përgatitur një komunikatë shtypi apo një artikull, të rinjtë mund të jenë të tërhequr dhe emrat e tyre të mos njihen. Por kur bëhet fjalë për një intervistë radiofonike apo pjesëmarrjen në një emision televiziv, nuk ka vend për anonimatin apo që të rinjtë të kenë mundësi të fshihen. Në këtë moment, grupi mund të përdorë komunikatën për shtyp të përgatitur në modulin “Mjetet e komunikimit, shtypi”, si një mjet për t’u lidhur me stacionet televizive.

Përgatitja

Para se të filloni modulin, merrni parasysh këto momente.

- **Zgjidhni stacionin televiziv apo radiofonik** që i përshtatet më mirë tematikës suaj. Stacionet televizive dhe radiofonike lokale mund të jenë më të interesuara për t’u lidhur me ju, por ndodh që dhe stacionet kombëtare të paraqesin interes. Pasi të keni përcaktuar stacionet, shikoni me kujdes emisionet që japin, dhe përzgjidhni ato emisione që përkojnë me interesat tuaja.

- **Merrni takim me stacionet televizive apo radiofonike paraprakisht.** Pasi të keni përcaktuar stacionin dhe programin, merrni takim me prodhuesin e programit. Gjithashtu, paraprakisht njoftoni stafin e këtyre programeve për qëllimet tuaja, si dhe paraqituni një komunikatë shtypi në lidhje me temën që trajtoni. Qëllimi është që duke vendosur lidhje me kohë, do të keni mundësi të caktoni kohën që ju duket më e përshtatshme për qëllimin tuaj.
- **Kujdes për kohën që do të zgjidhni.** Lajmet përfaqësojnë të tashmen, atë çka ndodh sot. Flisni për projektin tuaj kur ai zhvillohet, jo me javë më vonë apo kur mbyllet. Kjo do të thotë se, si mësues, duhet të vendosni për realizimin e modulit në kohën më të përshtatshme. Programojeni me kujdes.
- **Përfundimi.** Sigurohuni që stacioni televiziv apo radiofonik të marrë njoftimin tuaj të shtypit në kohën e duhur dhe lidhuni drejtpërdrejt me prodhuesin e programit për kohën kur do të jepet intervista.



Ashtu si shtypi i shkruar, edhe stacionet radiotelevizive, madje edhe ato lokale punojnë me ritëm të përshtatshëm. Çdo ditë transmetojnë shumë emisione dhe koha për ta është shumë e çmuar. Mënyra më e mirë për të tërhequr vëmendjen e tyre, është që një pjesë të mirë të punës së tyre ta kryeni ju. Pra, përgatisni një njoftim për shtyp që mund të përdoret si bazë për një diskutim apo intervistë dhe zhvilloni veprimtarinë duke mbajtur lidhje drejtpërdrejt me stacionin. Nëse e zhvilloni pjesën më të madhe të punës në bashkëpunim me stacionin, pjesa që ju do të përgatisni, do të jepet menjëherë.

Nëse dikush nga kolegët tuaj ka përvojë në marrëdhëniet me stacionet radiotelevizive, mos nguroni t'i kërkonti ndihmë dhe ta përfshini në realizimin e modulit.

Një zgjidhje tjetër është t'i kërkonti ndihmë ndonjë specialisti në çështjet e komunikimit, profesor, gazetër, pononjës i stacioneve televizive etj.

Mos harroni të përfshini edhe të rinjtë e grupit në gjetjen e ndihmësit të jashtëm. Nxitini dhe përkrahini duke ju siguruar takime me prodhues emisionesh apo nëpunës të tjerë të stacioneve radiotelevizive. Kjo do të jetë për ta një përvojë shumë e mirë, pasi do të mësojnë si të sillen me përfaqësues të medias. Dërgimi i një letre në një radio apo televizion duhet të paraprihet e të ndiqet me doemos nga një telefonatë.

Çfarë duhet



- ✓ Komunikata e shtypit që keni përgatitur në modulën "Mjetet e komunikimit, shtypi";
- ✓ Një dërrasë e zezë ose fletë tabaku;
- ✓ Sigurimi i një linje telefonike, por nuk është e detyrueshme;
- ✓ Videokamera dhe regjistratorë (kujdes, këto pajisje nuk janë të një rëndësie shumë të madhe, bëhet fjalë për pajisje të kushtueshme që jo gjithmonë gjenden). Nëse keni mundësi, përdorini.



Zhvillimi i modulit



Mënyra si do të procedohet, varet nga shumë faktorë.

Nëse keni arritur apo jo të ftoni një përfaqësues të medias.

Nëse keni siguruar apo jo një ndihmë të jashtme, një kolegun tuaj që do t'ju ndihmojë në zhvillimin e modulit.

Nëse do t'i drejtoni ju vetë ose jo sesionet.

Pavarësisht situatës në të cilën ndodheni, përjasja që bëhet më poshtë, do t'ju ndihmojë të zhvilloni këtë modul me dhe pa ndihmë të jashtme.

Shënim për përdoruesin

Ju këshillojmë që për këtë modul të punoni vetëm në një stacion radifonik ose në një stacion televiziv. Nëse e keni këtë mundësi, lërjani të rinjve të zgjedhin të përgatisin një intervistë radiofonike apo televizive, sipas kushteve. Do të ishte interesante të ndiqej sesi dy grupe përgatiten në mënyra të ndryshme për një intervistë radiofonike dhe për një intervistë televizive. Në diskutimin përfundimtar mund të ballafaqohen përvojat e të dyja grupeve.

Meqë ky modul zhvillohet pas modulit të mjeteve të komunikimit, shtypit, ruani të njëjtën ndarje në nëngrupe. Analiza e njoftimit të shtypit dhe përgatitja e pyetjeve të intervistës kërkojnë një parapërgatitje për t'i shkruar. Në këtë modul parashikohet një sesion i lojës me role, ku të rinjtë të luajnë si do të zhvillohet intervista. Këto ushtrime do t'i ndihmojnë të rinjtë të fitojnë më shumë besim në vetëvete, një element ky shumë i rëndësishëm, para se të futesh në botën e medias.

Nëse i keni realizuar modulet "Loja me role" dhe "Debati", do të jeni në gjendje të përzgjedhni aktorët dhe oratorët më të mirë të grupit. Bëni kujdes që të mos të jenë të gjithë në të njëjtin nëngrup, por të jenë të shpërndarë. Në këtë moment këta individë mund të luajnë rolin kryetarit të grupit që do të ishte një ndihmë tjetër për ju.

Organizimi i grupit




Përgatitja e skenës

1 orë mësimi

Nëse këni patur mundësi të takoni një gazetar apo një përfaqësues tjetër të botës së radios a të televizionit, ky do të jetë një fillim i mbarë për punën tuaj. Ftojuni këtë person t'i flasi grupit para se të filloni punën. Kjo do t'u ndihmojë të hyni në atmosferën e kësaj pune dhe të nxisni interesin e grupit në lidhje me këtë argument. Në përfundim të paraqitjes, jepuni hapësirën e duhur pyetjeve, duke filluar nga ju që do të bëni pyetje që i keni përgatitur më parë. Nuk ndodh gjithmonë që të rinjtë të marrin nismën për të bërë pyetje. Edhe kur kanë shumë pyetje për të bërë, shpesh ata ndiehen të ndrojtur të shprehin dyshimet apo moskuptimet e tyre. Thyejeni ju të parët akullin dhe bëni pyetjet e para. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një klime me miqësore dhe do ta shihni që fëmijët do të fillojnë të pyesin.

Ju kujtojmë që më pas t'i dërgoni një letër falenderimi personit që ju foli. Kjo është një shenjë mirësjelljeje, por të jeni të sigurtë që do të ketë ndikimin e duhur tek personat e interesuar. Gjeste si këto, edhe pse janë gjëra të vogla, vlerësohen dhe do ta shikoni që në të ardhmen këta persona do të jenë të gatshëm të bashkëpunojnë me ju.

Radioja vlerësohet si një mjet komunikimi më pak terheqës se televizioni, i cili në shoqërinë moderne është mjeti më i shpejtë dhe efektiv i shpërndarjes së lajmit. Një pjesë e mirë e parimeve, të vlerave e të sjelljeve të të rinjve bazohen në modelet që jepen në programet televizive. Shumë programe televizive u drejtohen adoleshentëve. Fakti është se në shumë vende, radioja nuk përcaktohet si mjet i shpejtë i shpërndarjes së lajmit, por gjithësesi mbetet një mjet komunikimi shumë i rëndësishëm.



Radioja përcaktohet si një mjet që ofron shumë përparësi kundrejt televizionit, pasi është më pak e kushtueshme, pra më e arritshme. Njerëzit dëgjojnë radion gjatë gjithë ditës, gjithë vitin dhe nuk janë të ndërgjegjshëm që e dëgjojnë. Në pjesën më të madhe të shtëpive dhe të mjediseve publik ka të paktën një radio. Në shumë vende të varfra, ku nuk ka rrymë elektrike të vazhdueshme dhe ku jo të gjithë janë në gjendje të blejnë televizorë, radioja mbetet mjeti më i rëndësishëm i informacionit për njerëzit

Si radioja, ashtu dhe televizioni kanë një sasi të gjerë programesh, si: lajmet, talk show, emisione speciale, emisione arsimore e edukative, emisione ku mund të ndërhyhet nëpërmjet telefonit, emisione për grupe të caktuara njerëzish, gra, fëmijë, adoleshentë etj. Së bashku me grupin duhet të konsultoheni për të gjetur programin më të përshtatshëm për projektin tuaj. Shpesh fëmijët ndjekin programe që krijohen posaçërisht për ta.

Gjithashtu, duhet të vlerësoni që radiot lokale janë shumë të ndjekura, pasi janë të familjarizuara me informacionet lokale që u interesojnë të rinjve, parashikimin e kohës dhe lajme për ngjarje lokale. Radiot lokale mund të jenë një pikënisje shumë e mirë për grupin tuaj. Jo rrallë këto radio janë në kërkim të lajmeve dhe problemeve të lokalitetit për ta bërë më interesant programin.



Veprimtaria 1

Intervistë radiofonike ose televizive

2 orë mësimi

Një ndër format më të mira të shpërndarjes së lajmit janë intervistat. Ky modul synon t'i përgatisë të rinjtë për këtë formë komunikimi. Përfundimet e arritura gjatë realizimit të modulit "Mjetet e komunikimit, shtypi" do të jenë në themel të kësaj veprimtarie. Secili grup do të ketë një kopje të njoftimit të shtypit, e cila mendohet se është dhënë nga radioja ose televizioni lokal. Objektivi është që, nëpërmjet lojës me role, nëngrupet të analizojnë përmbajtjen e komunikatës dhe të formulojnë një sërë pyetjesh për personat e përfshirë në projekt.



Shënim për përdoruesin

Nuk është e nevojshme të keni zhvilluar modulin "Loja me role". Në këtë modul, pjesa që i kushtohet lojës me role, nuk është aq e rëndësishme, prandaj mos u shqetësoni për aftësitë interpretuese të grupit.

Teknika e intervistës

Filloni me një diskutim të përgjithshëm. Në dërrasën e zezë shkruani rregullat e mëposhtme që janë të nevojshme për përgatitjen e intervistës.

- **Përgatitu, përgatitu, përgatitu!** Intervista nuk është e lehtë, madje edhe kur je mësuar me të. Duke e planifikuar intervistën, krijon mundësi që të rinjtë të përgatiten mendërisht dhe të përqendrohen në qëllimin kryesor dhe në përcjelljen e mesazhit.

- **Respektimi i orarit.** Është e rëndësishme që të mbrini në orar për realizimin e intervistës, në mënyrë që të mos humbet kohë kot duke pritur.
- **Për çfarë flitet në histori.** Që intervista juaj të tërheqë vëmendjen e dëgjuesve, duhet të përmbajë një histori dhe, ajo që është e rëndësishme, të gjeni mënyrën si do ta përcillni atë.
- **Të paraqiteni.** Është shumë e rëndësishme të paraqiteni saktësisht kush jeni, në mënyrë që dëgjuesi të mund të përqsë historinë që tregoni me problematikën.
- **Flisni me fjali të thjeshta dhe të shkurtra.** Gjatë një interviste radiofonike mos u shpërndani. Flisni me qartësi dhe me saktësi. Mos këmbëngulni në të njëjtën pikë. Pasi mendoni se e keni sqaruar një çështje, kaloni tek tjetra.
- **Mënjanoni përdorimin e zhargoneve.** Shpesh të rinjtë kanë prirjen të përdorin zhargone, prandaj është e nevojshme të këmbëngulni që ata të transmetojnë mesazhin me një gjuhë dhe në mënyrë të qartë.
- **Përcaktoni saktësisht mesazhin që do të përcillni.** Cilësia e intervistës do të gjykohet mbi atë sa keni arritur të përcillni mesazhin tek dëgjuesi. Prandaj, mendojeni mirë se cilin mesazh do të përcillni. Përgatitni një listë me 5 çështje që ju do të trajtoni në intervistë, dhe çdo gjë që të ndodhë gjatë intervistës. Duhet të cekni të pesta çështjet. Një prej tyre do të jetë falenderimi i të gjithë personave që kanë ndihmuar. Sekret i është në interpretimin e pyetjes në mënyrë të tillë që ju, i intervistuari, të mund të thoni saktësisht atë që dëshironi. Nëse flisni qartë dhe mirë, nuk kanë përse t'ju ndërpresin.
- **Në fjalën tuaj fusni dhe të dhëna statistikore të përzgjedhura me kujdes.** Në lidhje me punën e fëmijëve ka statistika shumë tronditëse që ju mund t'i përdorni për të përforcuar mesazhin që përcillni. Një intervistë zgjat disa minuta ose dhe disa sekonda. Një mënyrë e mirë për të tërhequr vëmendjen e publikut, është paraqitja e të dhënave shokuese. Ballafaqoni statistikat me gjendjen në mënyrë që njerëzit të fillojnë të mendojnë me seriozitet për këtë problem.





- **Mos harroni që po ju shikojnë.** Një ndër problemet shumë të rëndësishme në një intervistë televizive është pamja fizike. Në një intervistë televizive, personi është në qendër të saj gjatë gjithë kohës që zgjat. Në këtë mënyrë, gjuha shprehëse e paraqitjes është po aq e rëndësishme: të rinjtë duhet të bëjnë kujdes në lëvizjet e tyre, të qëndrojnë drejt në karrike, të jenë të qetë dhe t'i mbajnë duart në mënyrë të natyrshme.

Përgatitni listën në mënyrën që ju e quani më të drejtë. Qëndroni në ato çështje që ju mendoni se kanë nevojë të diskutohen. Shkruani në dërrasë të zezë vetëm pikat e rëndësishme. Pasi t'i keni shkruar, sqaroni të gjitha çështjet deri në fund.

Gjatë trajtimit të çështjeve, lërni vend pyetjeve që bëjnë të rinjtë, në mënyrë që gjithçka të sqarohet deri në fund. Verifikoni që gjithçka është kuptuar nëpërmjet pyetjeve që do të bëni. Ruani vëmendjen e auditorit, duke shtruar pyetje dhe duke bërë shpjegime të shoqëruara me shembuj.

Përgatitja për intervistë

Ky ushtrim synon në realizimin e një interviste në formën e lojës me role, një formë e dramatizuar e një interviste radiofonike. Qëllimi është që pjesëtarët e grupit të përgatiten për të dyja rolet: të intervistuesit dhe të të intervistuarit. Mirë është që t'i ndani të rinjtë në një numër të barabartë të nëngrupeve. Çiftëzohini nëngrupet ndërmjet tyre, në mënyrë që të jenë dy nëngrupe me nga dy persona. Të dyja nëngrupet do të kenë detyra të ndryshme

- Njëri nëngrup do të luajë rolin e intervistuesit radiofonik, do të ketë si detyrë të lexojë komunikatën e shtypit dhe të përpunojë disa nga pyetjet e mundshme. Ky ushtrim kërkon një analizë të vëmendshme të komunikatës së shtypit. Përpiquni të jeni i thjeshtë në kërkesat që do t'i bëni grupit, në mënyrë që të rinjtë të mos shkurajohen. Kërkojuni të formulojnë 6 pyetje. Pikërisht ato pyetje që do të dëshironin të bënin nëse do të ishin në rolin e intervistuesit. Shpjegojuni që pyetjet duhet të jenë të menduara dhe të hapura, në mënyrë që t'i japin mundësi të intervistuarit të përgjigjet, duke e trajtuar gjerë çështjen. Pyetjet e thjeshta që kërkojnë si përgjigje një po apo jo, do ta bënin intervistën pa interes.

- Nëngrupi i dytë do të luajë rolin e të intervistuarit. Të rinjtë do ta analizojnë njoftimin e shtypit nga një këndvështrim i ri, duke mbajtur qëndrim rreth mesazhit që dëshirojnë të transmetojnë nëpërmjet intervistës. Pra, duhet të përgatiten për t'iu përgjigjur intervistuesit.

Të dyja nëngrupet do të punojnë veçmas dhe nuk duhet të ballafaqojnë analizat e tyre. Qëllimi i këtij ushtrimi është të nxirren në pah se cilat mund të jenë pyetjet dhe përgjigjet e mundshme. Pra, qëllimi është t'u ofrohen të rinjve disa njohuri që mund të shfrytëzohen prej tyre nëse do të merren në intervistë në radio apo në televizion dhe në të njëjtën kohë t'i nxisë të mendojnë dhe të mbajnë qëndrim rreth projektit që kanë për punën e fëmijëve.

Lërimi grupit rreth 20 minuta për të përgatitur intervistën. Mbajeni atmosferën e gjallë duke dhënë udhëzime dhe duke kaluar nga një nëngrup tek tjetri. Nëse dalloni se një nëngrup është në vështirësi, afrojuni dhe ndihmoheni. Bisedoni me pjesëtarët e tij rreth pyetjeve që mund të bëjnë, duke marrë për bazë komunikimin e shtypit, si dhe duke bërë aty-këtu ndërhyrjet e duhura. Pasi të keni kapërcyer fazën e parë, puna do të jetë më e thjeshtë.

Sigurohuni që gjithçka shkon mirë. Formulimi i pyetjeve nuk është ndonjë vështirësi e madhe, pasi në këtë moment të rinjtë e njohin mirë çështjen për të cilën diskutojnë. Bëjuni të ditur që në këtë nivel të zhvillimit të ushtrimit, nuk pritet që të kenë rezultate të shkëlqyera. Objektivi në këtë fazë është që të rinjtë të shkruajnë pyetjet dhe të përgatiten për intervistën. Gjithashtu, sigurohuni që në këtë punë të marrin pjesë të gjithë anëtarët e grupit dhe pyetjet të mos jenë rezultati i punës së një personi. Respektoni orarin që keni caktuar për fillimin e fundin e ushtrimit, mos e zgjasni ushtrimin përtej kohës së caktuar edhe nëse nuk kanë mbaruar të gjithë.



Ushtrimi për të bërë intervista

Në përfundim të ushtrimit, sistemoni në qendër të klasës një tavolinë. Nga njëra anë e tavolinës do të jenë të intervistuarit dhe nga ana tjetër intervistuesit. Me mënyrë demokratike do të përcaktohet rendi i paraqitjes së intervistave. Nëse keni një videoregjistrues, filmojini të gjitha intervistat. Analiza e tyre, me të gjithë grupin, nga të dyja këndvështrimet, të intervistuesit dhe të të intervistuarve, do ta ndihmonte të gjithë grupin të kuptojë se çfarë është e nevojshme të bëje dhe çfarë duhet të mënjanohet gjatë një interviste.

Regjistrimi ka vlerë për një sërë arsyesh.

- Situata bëhet më e besueshme. Është e natyrshme të kesh emocione dhe shqetësime kur bën një intervistë. Prandaj është e rëndësishme t'i provosh këto emocione dhe të shikosh si ndikojnë në rendimentin tuaj.
- Regjistrimi ndihmon në krijimin e një ideje më të qartë se çdo të thotë të shikohesh nga një publik që e ke të pranishëm dhe nga në publik tjetër që nuk e shikon.

Mundohuni t'u mësoni të gjithëve të regjistrojnë me videokamera, pasi është një mjet shumë i rëndësishëm.

Në rastet që nuk keni një videoregjistrues, mos u shqetësoni. E rëndësishme është që të gjithë të marrin pjesë në ushtrim. Përvoja e lojës me role thëllon në një farë mënyrë elementet që të rinjtë kanë mësuar. Gjithashtu, është i dobishëm edhe rishikimi i intervistës, nëse e keni regjistruar. Në këtë mënyrë mund të ndaleni dhe të analizoni elemente të veçanta të intervistës me të gjithë grupin. Për të rinjtë, të ridëgjojnë atë që kanë thënë, është pa dyshim një përvojë shumë e dobishme didaktike. Ka të ngjarë që nuk kanë arritur të fusin në kujtesë gjithçka që kanë thënë gjatë intervistës.

Vendosini të rinjtë në tavolinë dhe parapërgatitini duke i futur në rolin që do të luajnë. P.sh., nëse do të jenë intervistues, paraqitini me një emër tjetër dhe ftojini të paraqesin një emision, p.sh., një intervistë ose parashikimin e kohës. Të gjithë të rinjtë që janë caktuar për të bërë pyetje, duhet të marrin pjesë në këtë ushtrim. Për të gjithë kohën që zgjat ushtrimi, mos i jepni fjalën vetëm një personi. Në mënyrë të njëjtë, të gjithë të rinjtë që do të



jenë në rolin e të intervistuarit, duhet të përgjigjen në mënyrë që të dyja palët të përfshihen.

Intervistuesit duhet t'u japin mundësi të intervistuarve që të plotësojnë dhe të zgjerojnë më tej përgjigjet e tyre, pasi është kjo strategjia që ndiqet gjatë intervistave të vërteta. Kujtojeni të rinjve që intervistohen, të theksojnë qartë mesazhin që duan të përcjellin dhe të sigurohen që e kanë realizuar mirë këtë objektiv.



Është e rëndësishme të kujdeseni që atmosfera në grup të jetë e këndshme dhe e qetë. Atje ku është e mundshme, përdorni dhe ironinë e shakanë pa humbur kontrollin e grupit. Qëndroni pranë nëngrupeve dhe ndihmohuni t'u përgjigjen pyetjeve. Mund të ndodhë që ndonjë prej të rinjve të bllokohet (frika ndaj publikut është një dukuri që ndeshet në të tilla situata), qëndroni i gatshëm që t'i ndihmoni të rinjtë në vështirësi të dalin me dinjitet nga situata.

Në përfundim të intervistës së bërë nga të gjitha nëngrupet, falenderojini për punën e kryer dhe drejtojuni të tjerëve për të shprehur komentet e rastit rreth performacës së nëngrupeve. Duke vëzhguar punën e nëngrupeve, të rinjtë duhet të nxjerrin mësimë për t'i zbatuar kur t'u vijë radha të zhvillojnë intervistat e tyre. Është e udhës që nëngrupet të analizojnë lojën e shokëve, pasi kjo i ndihmon mbajtjes gjallë të ritmit të punës. Vazhdoni në këtë mënyrë derisa të gjithë ta kenë kryer këtë ushtrim. Merrni në shënim anët pozitive dhe negative për t'i vënë në dukje gjatë diskutimit përfundimtar. Nënvizoni dhe nxirrni në pah anët pozitive dhe mundohuni të bëni komente vlerësuese për ato anë që kanë çaluar. Në përfundim të lojës më role, të rinjtë do të kenë përfituar shumë.

Nëse e vlerësoni si të dobishme (dhe nëse vetë të rinjtë e pranojnë këtë propozim), nxisni një frymë të lehtë gare ndërmjet nëngrupeve për të rritur interesin dhe atmosferën e gjallë që mbart gara. P.sh.:

- Jepni një çmim për interpretimin më të mirë (juria të përbëhet nga pjesëtarët e grupit)
- Jepni një çmim për interpretimin më komik.

Intervista

Pasi të ketë përfunduar ushtrimin, të gjitha energjitë e grupit të drejtohen në krijimin e lidhjeve me radion apo televizionin lokal për të përgatitur intervistën e vërtetë. Natyrshëm, jo të gjithë mund të marrin pjesë në këtë veprimtari. Kështu, vetëm dy prej të rinjve mund të marrin pjesë dhe është e udhës që t'i shoqëroni edhe ju si përgjegjës për realizimin e projektit. Ndërkohë, gjeni një rrugë të paanshme dhe të hapur për të caktuar se kush do ta bëjë intervistën. P.sh., mund të shënoni emrat e të gjithë atyre që dëshirojnë të bëjnë intervistën, dhe më pas ta hidhni në short kush do të fitojë.

Pasi të jetë përcaktuar data dhe orari i intervistës, realizoni një sesion përgatitor për t'i mësuar të jenë sa më të lirshëm përpara kamerës. Rikthejuni shënimeve që keni marrë gjatë zhvillimit të lojës me role, dhe flisni për anët pozitive që keni veçuar. E rëndësishme është të kenë të qartë mesazhet që duan të transmetojnë. Jini në kohë në vendin e intervistës dhe kujtojuni intervistuesve të falenderojnë në përfundim të saj. Kur të mbarojë intervista, mblidhni të gjithë të rinjtë e grupit në një takim joformal, p.sh., në një lokal ku të marrin diçka dhe lirshëm të shprehin mendimet e tyre rreth kësaj përvoje. Kjo është një mënyrë për të shkarkuar gjithë tensionin e mbledhur.

Mos harroni të falenderoni të rinjtë për punën e mirë që kanë kryer (në këtë mënyrë nxisni vetëvlerësimin e tyre) dhe, njëkohësisht, falenderojini të gjithë për ndihmesën që kanë dhënë. Më pas, grupi zgjedh një person, i cili do t'i shkruajë letrën e falenderimit stacionit radiofonik apo televizionit.

Ç'duhet bërë dhe ç'duhet mënjanuar

- Merrni masa që të gjithë të rinjtë e grupit të marrin pjesë në të gjitha sesionet e modulit.
- Përdorni shakanë dhe batutat gjatë zhvillimit të të gjitha sesioneve. Elemente të humorit mund të jenë të rëndësishme edhe në interpretimin e roleve të ndryshme. Ndonjëri mund të imitojë edhe ndonjë personazh të radios apo televizionit që është i njohur.
- Mos lejoni që pjesëtarë të grupit të nëpërkëmbin punën e të tjerëve. Puna e të gjithëve meriton respekt dhe vëmendje.
- Nëse keni mundësi, regjistroni intervistat në video apo edhe në magnetofon.
- Mos i detyroni të rinjtë të bëjnë atë që nuk dëshirojnë. Gjithçka duhet të bëhet në frymën e mirëkuptimit. Disa, nga natyra, vijnë të ndrojtur dhe nuk e kanë të lehtë të dalin para një publiku të gjerë. Është detyra juaj të mbani parasysh dhe të vlerësoni gjendjen emocionale të të gjithëve.
- Mos e teproni me elementet e garës, por përdorini për objektiva afatshkurtër. Nëse mendoni që mund t'ju sjellin shqetësime, mos i përdorni fare.




Diskutimi përfundimtar

1 orë mësimi

Pasi të gjithë të kenë zhvilluar ushtrimin e lojës me role, vazhdoni me diskutimin përfundimtar. Veprimtaritë me mediat dhe veçanërisht me radion ose televizionin janë të këndshme dhe ka shumë gjasë që grupi t'ë jetë plotësisht pjesëmarrës në këtë fazë. Nëse do të keni arritur të bëni një intervistë në radio apo televizion, entuziazmi i grupit do të jetë edhe më i madh. Të rinjve u pëlqen të dalin në emisionet radiofonike apo televizive pasi komuniteti ky ata jetojnë, do të njihet me atë që ata bëjnë dhe mësojnë. Mos harroni ta regjistroni këtë ngjarje që do ta përdorni në fazën përfundimtare të projektit.

Mbajeni të gjallë atmosferën e grupit në fazën përfundimtare duke shprehur gjallërisht mendimet dhe vlerësimet që keni. Mbajini në dijeni të rinjtë në lidhje me përgjigjet që kanë sjellë stacionet e radios apo të televizionit. Madje, ju mund të synoni të përdorni edhe një stacion televiziv apo radiofonik kombëtar. Ky do të ishte një sukses i padiskutueshëm i projektit dhe i grupit të të rinjve. Madje kjo do të krijonte një klimë shumë pozitive dhe nxitëse për të ndër marrë veprimtari të tjera. Mos harroni që në emisionin televiziv të paraqesni edhe punët artistike që keni bërë gjatë zhvillimit të moduleve të ndryshme të projektit.



Vlerësimi dhe vazhdimi

Në lidhje me treguesit që do të masin suksesin e këtij moduli, duhet të shikoni nëse janë arritur ose jo disa rezultatet të caktuara. Vlerësoni a është realizuar loja me role ku nëngrupet të kenë përgatitur një skenar dhe të kenë interpretuar rolet në formën e një interviste radiofonike apo televizive. Cilësia e kësaj pune varet nga mënyra si është zhvilluar moduli, si dhe klima e raportet që janë krijuar në gjirin e nëngrupit.

Ndër treguesit e tjerë duhet të vlerësohen:

- Marrëdhëniet e krijuara me televizionin apo radion (lokale apo kombëtare);
- Transmetimi i komunikatës së shtypit për mediat;
- Oferta për të zhvilluar emisione apo intervista nga stacionet radiotelevizive. Ndoshta grupi është përfshirë në një talk show , në një dokumentar për projektin apo ka marrë pjesë në një emisione për fëmijë;
- Zhvillimin e veprimtarive të tjera pas intervistës.

Të gjitha veprimtaritë e këtij moduli synojnë t'i hedhin të rinjtë në aksion dhe t'i përfshijnë efektivisht në fushatën globale për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Treguesit e sipërpërmendur ju ndihmojnë të vlerësoni sa të rinjtë e grupit janë të gatshëm të veprojnë dhe sa janë përfshirë në problematikën e projektit. Këto rezultate janë shumë të rëndësishme për ju si edukatorë, pasi do t'ju lejojnë të vlerësoni pjesëmarrjen e grupit, në tërësi dhe të elementeve të veçanta në kuadrin e grupit. Pa dyshim, në këtë moment ju jeni në gjendje të veçoni elementet më të përfshira dhe më të dallueshme që mund të japin një ndihmesë pozitive në luftën kundër punës së fëmijëve.

Ky modul është veçanërisht i rëndësishëm për edukimin e të rinjve të grupit tuaj. Veprimtaritë e përfshira në të, do t'i ndihmojnë të rinjtë të kuptojnë si duhet të lëvizin për të rrituri ndërgjegjësimin ndaj problemit të punës së fëmijëve. Të rinjtë kanë mundësi të shprehin ndjenjat para komunitetit të tyre, madje nuk përjashtohet që kjo gjë të bëjë të lindin lëvizje të reja. Ndoshta do të nxisin interesin e grupeve të tjera. Shkollat, në përgjithësi, mund të paraqesin interes



për punën e bërë nga të rinjtë e grupit. Botimi i komunikatës për shtyp mund të jetë çelësi magjik që mund të hapë shumë porta.

Veprimtaritë e modulit duhet t'i transmetojnë të gjithë grupit një mesazh shprese. Vetë të rinjtë mund të bineden që jo gjithçka është e kotë, por ekzistojnë mundësi dhe mjete për të vepruar në mënyrë pozitive. Nëse moduli udhëhiqet dhe menaxhohet në mnyrën e duhur, mund të ketë rezultate shumë dobiprurëse. Nëse intervistat realizohen në mënyrë të rregullt dhe kanë sukses, kjo do t'u japë besim të rinjve dhe do t'i motivojë që të vazhdojnë në këtë rrugë.

Pasi te keni përfunduar këtë modul, ju këshillojmë të vazhdoni me module që ju japin mundësi të njiheni me aspekte të tjera të fushatës. P.sh., të realizoni modulin "Integrimi dhe komuniteti".